



VENDIM

Nr. 88, Datë 30.06.2015

PËR

MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 98 pika 2 të Ligjit nr. 43/2015, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.06.2015, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut, ne lidhje me një ndryshim ne Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, date 23.06.2008, të ndryshuar,

Vendosi:

1. Pika 1 e Vendimit nr. 39 datë 18.03.2015, të Bordit të ERE-s, ndryshohet si me poshtë:
Vendimi nr. 93, date 16.07.2012, do të shtrijë efektet deri në datën 30.09.2015.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMETI